



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË  
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO  
FOOD AND VETERINARY AGENCY

### KONKURS I BRENDSHËM

---

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me numër reference: **AUV, 01 - 431/2019**, shpallë të lirë këtë vend të punës:

1. Titulli i vendit të punës: **Udhëheqës i Sektorit të Higjienës së Ushqimit me prejardhje joshtazore - Një (1) pozitë**  
Koeficienti: **Nëntë (9)**  
Lloji i pozitës: **I karrierës**

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Hartimi i politikave për kontrollin e higjienës së ushqimit me prejardhje joshtazore, përfshirë prodhimin, përpunimin, paketimin, ripaketimin, deponimin, transportin, tregtimin, importin dhe eksportin e ushqimeve dhe lëndës së parë;
- Përcaktimi i procedurave për aprovimin dhe regjistrimin e objekteve që merren me prodhimin, përpunimin, paketimin, përgatitjen, dhe tregtimin e ushqimeve me origjinë joshtazore;
- Përgatitja e legjislacionit për përcaktimin e kërkesave higjienike në aspektin e shëndetit publik, sigurisë, cilësisë së ushqimit dhe kërkesave të tjera, sipas legjislacionit në fuqi si dhe kërkesat për ushqime tradicionale dhe gjeografikisht të mbajtura;
- Hartimi i planeve nacionale të kontroleve zyrtare, hartimin e formave dhe përmbajtjes së certifikatave shëndetësore për ushqime me origjinë jo shtazore;
- Hartimi i pyetësorëve të kontrollit për operatorët e biznesit të cilët merren me ushqim me prejardhje joshtazore;
- Përpilimi i planeve dhe programeve për trajnimin e inspektorëve në fushën e higjienës së ushqimit me prejardhje joshtazore;
- Përpilimi i planit të përgjithshëm për menaxhimin e krizave në aspektin e sigurisë së ushqimit me prejardhje joshtazore;

- Përpilimi i planeve për lajmërim dhe reagim të shpejtë në rastet e rrezikut me ushqim me prejardhje joshtazore, bashkëpunon me sistemin RASFF;
- Përpilimi i strategjisë së komunikimit për informim të konsumatorit, shoqatave të konsumatorëve dhe palëve të tjera të interesuara në aspektin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit me prejardhje jo shtazore;
- Pranimi dhe vlerësimi i ankesave të konsumatorëve, shoqatave të konsumatorëve dhe personave të tjerë në aspektin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit me prejardhje joshtazore;
- Kryen edhe punë të tjera me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetin publik të cilit edhe i përgjigjet për punën e vet.

**Shkathtësitë e kërkuara:** ( kualifikimi, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Ushqimit me prejardhje joshtazore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Shkathtësi organizative dhe komunikuese;
- Diplomë Universiteti - Fakulteti i Bujqësisë, Teknologjisë Ushqimore, Kimisë Biologjisë, ose drejtime relevante;
- Katër (4) vite përvojë pune në profesion;
- Vërejtje: Diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës pas vitit 1990 duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT.

#### **Procedura e konkurimit:**

Procedura e konkurrimit është e hapur vetëm për nëpunës civil ekzistues, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kërkesa për plotësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Zona Industriale p.n.

Formularin zyrtar për aplikim mund ta gjeni edhe në Ueb faqen <http://www.auv-ks.org/>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pa kompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pa vlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës nr. N-103 kati i parë, ndërtesa e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ose me postë.

#### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të lartë të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Afati i konkurimit është prej datës 17.09.2019 deri me datë 24.09.2019 në ora 16:00.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem na kontaktoni në numrin: 038/ 200-38-304.